



UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
"FEHMI AGANI"  
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës  
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/318  
Datë: 06/03/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1.15 dhe nenit nenin 22 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani, në mbledhjen e mbajtur më 03.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Qendra Shëndetësore Universitare e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Autorizohet menaxhmenti i Universitetit të Gjakovës që t'i ndërmerr veprimet e nevojshme dhe t'i koordinojë aktivitetet për sigurimin e kushteve ligjore për licencim dhe funksionalizim të Qendrës Shëndetësore në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi dhe aktet përcjellës në-ligjore.
- III. Funksionimi i Qendrës Shëndetësore do të bëhet pas miratimit të akteve të përgjithshme normative të Qendres, nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës dhe licencimit nga Ministria e Shëndetësisë ose organi i autorizuar prej saj, në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara me Ligjin për Shëndetësi dhe aktet përcjellës në- ligjore.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh rëndësin e Qendrës Shëndetësore Universitare, që synon ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor primar për studentët dhe për personelin e Universitetit dhe mbi mundësit e punës praktike të studentëve, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Menaxhmentit;
- Sekretarit të përgjithshëm
- Zyrës së personelit;
- Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova